



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 26.07.2019)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të përzgjedhjes së kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur, për në pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë dhe caktimi i relatorit për secilin kandidat”.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:07 dhe mbaroi në orën 14:57.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                            |                          |
|----------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b>  | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>      | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Dritan Hallunaj</b>  | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>6. Ilir Toska</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Alban Toro</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Brikena Ukperaj</b>  | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Erjon Muharremaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>10. Marçela Shehu</b>   | <b>(anëtare)</b>         |

***Shënim:*** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***zonja Brunilda Kadi.***

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.***
- 2. Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.***
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.***
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.***
- 6. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.***
- 7. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.***
- 8. Aurora Ndreu, Specialiste pranë Sektorit të Oponencës Juridike dhe Përafrimit të Legjislacionit.***
- 9. Edlira Bako, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.***
- 10. Sindi Liço, Qendra Evropiane.***
- 11. Erion Fejzulla, USAID.***
- 12. Julinda Beqiraj, EURALIUS.***
- 13. Përfaqësues të medias (Prezent vetëm në pikën e parë.)***

#### **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve të përzgjedhjes së kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur, për në pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë dhe caktimi i relatorit për secilin kandidat”.

***Naureda Llagami:*** Atëherë, përshëndetje!

Këshilli i Lartë Gjyqësor fillon mbledhjen e parashikuar për datën 26 korrik 2019, ku të pranishëm janë të gjithë anëtarët, përveç zonjës Brunilda Kadi. Për arsye personale nuk ndodhet e pranishme në këtë mbledhje.

Siç jeni në dijeni, në rendin e ditës janë dy çështje mjaft të rëndësishme për shqyrtim nga ana e Këshillit.

Çështja e parë ka të bëjë lidhur me shqyrtimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve të përzgjedhjes së kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur, për në pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë dhe caktimin e relatorit për secilin kandidat”. Dhe çështja e dytë ka të bëjë me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Atëherë, pa humbur kohë, le të fillojmë me çështjen e parë.

Siç jeni në dijeni, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 23 maj 2019, ka miratuar me vendimin nr. 75, datë 23.05.2019 lidhur me procedurat e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë. Me anë të kësaj vendimmarrjeje Këshilli ka hapur rrugën edhe procesit të përzgjedhjes së kandidatëve jo-gjyqtarë për emërim në Gjykatën e Lartë.

Gjithashtu, me vendimet nr. 108, nr. 109, dhe vendimin nr. 110, të datës 09.07.2019, KLGJ shpalli nisjen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, duke u bërë thirrje kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur, për tre pozicione të lira, përkatësisht në fushën e së drejtës administrative, në fushën e së drejtës civile dhe në fushën e së drejtës penale. Afati i kandidimit ishte dy javë nga momenti i publikimit në faqen zyrtare të vendimit.

Pas përfundimit të këtij afati që përfundon më datë 25.07.2019, u konstatuan se gjithsej janë paraqitur 22 kandidatë për në Gjykatën e Lartë. Kërkesa e fundit e kandidatëve është e zotit {...}, i cili erdhi si kërkesë pranë institucionit tonë ditën e sotme, pra më datë 26.07.2019, kërkesë e cila është nisur me rrugë postare që më datë 24.07.2019. Mbështetur në Rregulloren që kemi miratuar me vendimin nr. nr. 75, sipas të cilit Këshilli mbart detyrimin që brenda 7 ditëve nga përfundimi i afatit të kandidimit të nisë procedurën e verifikimit të kandidatëve, dhe në të njëjtën ditë, në këtë Rregullore parashikohet që Këshilli duhet të caktojë relatorin për secilin kandidat.

Ndaj sa më sipër, Këshilli duhet të miratojë në këtë vendimmarrje, së pari: Nisjen e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të përzgjedhjes së kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur, për në pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë dhe së dyti, caktimin e relatorit për secilin kandidat që ka dorëzuar kërkesën për t'u emëruar në Gjykatën e Lartë.

Lidhur me caktimin e relatorëve që duhet të bëjnë verifikimin e kandidatëve, po në vijim të zbatimit të Rregullores së miratuar është përcaktuar që relatorë do të jenë anëtarët e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës. Ky Komision, për shkak të angazhimeve që kanë anëtarët e tij, i ka propozuar Këshillit që në procedurat e shortit, për caktimin e anëtarëve relatorë, të përfshihet edhe një nga anëtarët zëvendësues të këtij Komisioni, respektivisht zoti Dritan Hallunaj, anëtar i Këshillit. Kjo kërkesë është bazuar në seksionin A, pika 3, të këtij vendimi, ku parashikohet shprehimisht se: “Përjashtimisht, për arsye të motivuara që lidhen me ngarkesën dhe efektivitetin e punës, mbi propozimin e Komisionit, Këshilli mund të vendosë që në procedurat e shortit, për caktimin e relatorit, të përfshihen edhe anëtarët zëvendësues të Komisionit”.

Lidhur me këtë propozim, dëshiroj t'ia jap fjalën kryetarit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, zotit Ilir Toska.

***Ilir Toska:*** Faleminderit!

Atëherë, siç u relatua, ne kemi depozituar me shkrim, ne si Komision i Zhvillimit të Karrierës, një propozim për përfshirjen në procedurat e shortit për realizimin procedurave të verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të emërimit të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë, për sa i përket atyre që vijnë nga radhët e jo-gjyqtarëve, të përfshihet edhe anëtari zëvendësues, zoti Dritan Hallunaj, referuar ngarkesës aktuale që ka Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, që në vlerësimin tonë është një ngarkesë e lartë dhe do të donim që të përfshihej në procedurë edhe anëtarët zëvendësues të këtij Komisioni, siç është zoti Dritan Hallunaj, ndërsa anëtari tjetër zëvendësues, që jeni ju zonja Kryetare, nuk mund të përfshihen në procedura verifikimi si relatore, për shkak të pengesës ligjore që përcakton neni 63 i ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Ky është propozimi jonë që ftoj ta votoni nëse bini dakord.

***Naureda Llagami:*** Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kalojmë në votim propozimin e bërë nga Komisioni mbi përfshirjen e zotit Dritan Hallunaj si anëtar zëvendësues, për t'u përfshirë si relator për kandidatët.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, vazhdojmë me çështjen tjetër që lidhet me pjesën e procedurës së hedhjes së shortit, për sa i përket caktimit të relatorit për secilin kandidat. E gjej me vend të shpjegoj procedurën të parashikuar në rregulloren për këto kandidatë. Kështu, procedura e caktimit të relatorit do të organizohet duke futur në dy vazo qelqi, të palosura, shirita letre, ku në njërin vazo do vendosen emrat e anëtarëve të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, ndërkohë që në vazon tjetër do të jenë, emrat e 22 kandidatëve për anëtarë të Gjykatës së Lartë, të shkruar secili në një shirit letre, pra gjithsej 22 shirita letre të palosura, ku secili përmban emrat e kandidatëve, konkretisht si më poshtë:

1. {...}
2. {...}
3. {...}
4. {...}
5. {...}
6. {...}
7. {...}
8. {...}
9. {...}
10. {...}

11. {...}
12. {...}
13. {...}
14. {...}
15. {...}
16. {...}
17. {...}
18. {...}
19. {...}
20. {...}
21. {...}
22. {...}

Nëse nuk ka ndonjë propozim tjetër nga Komisioni për numrin e kandidatëve që do verifikojë secili anëtar, procesi i shortit... Po, kemi propozim. Po, zoti Toska!

**Ilir Toska:** Atëherë, ne si Komision, përfshirë edhe anëtarin zëvendësues, kemi propozim për shpërndarjen e ngarkesës së punës, që zoti Toro dhe zonja Shehu nga 7 kandidatë për verifikim, zoti Hallunaj 5, dhe unë si kryetar i Komisionit 3 kandidatë.

Përveç kësaj, kisha edhe një propozim për sa i përket procedurave të shortit. Mënyra se si ju prezantuat procedurat e shortit mund të jetë jo efektive, pra për secilin kandidat të përzgjedhim një emër anëtar. Mundet të përzgjedhim një emër anëtar, në varësi të numrit që shpërndamë për ngarkesën e punës, të përzgjidhen të gjithë kandidatët. Do të ishte më efektive.

**Naureda Llagami:** Atëherë, kalojmë me propozimin e parë në votim. Jemi dakord lidhur me shpërndarjen e ngarkesës ndërmjet anëtarëve të Komisionit sipas propozimit të bërë nga zoti Toska?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

(Vota e zotit Muharremaj nuk dëgjohet.)

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, për të vijuar, jemi dakord lidhur me procedurën që do hedhim shortin për sa i përket anëtarëve, që secili anëtar të zgjidhen 7 kandidatët dhe të vijojmë në këtë lloj mënyre?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, unë i thërras punonjësit e administratës për të asistuar Këshillin lidhur me përgatitjen e procesit të hedhjes së shortit.

**Elis Kuçi:** Atëherë, sipas procedurës së miratuar në Këshill, si fillim do vendosim 4 emrat e anëtarëve në një enë.

Anëtarët janë: z. Ilir Toska, znj. Marçela Shehu, z. Alban Toro dhe z. Dritan Hallunaj.

Vijojmë me kandidatët.

1. Z. {...};
2. Z. {...};
3. Z. {...};
4. Znj. {...};
5. Znj. {...};

6. Z. {...};
7. Znj. {...};
8. Znj. {...};
9. Znj. {...};
10. Znj. {...};
11. Z. {...};
12. Z. {...};
13. Z. {...};
14. Znj. {...};
15. Znj. {...};
16. Z. {...};
17. Znj. {...};
18. Z. {...};
19. Z. {...};
20. Znj. {...};
21. Z. {...};
22. Z. {...}.

Si fillim përziejmë dhe kapim një nga anëtarët e Komisionit.

*(Përzgjidhet anëtari i parë i Komisionit.)*

Zoti Ilir Toska.

Për zotin Toska do kapim 3 emra.

*(Përzgjidhen tre emrat e kandidatëve.)*

1. Z. {...};
2. Znj. {...};
3. Z. {...}.

Vijojmë me relatorin tjetër.

*(Përzgjidhet anëtari i dytë i Komisionit.)*

Zoti Alban Toro.

Zoti Toro do jetë relator për 7.

*(Përzgjidhen shtatë emrat e kandidatëve.)*



1. Znj. {...};
2. Z. {...};
3. Z. {...};
4. Znj. {...};
5. Znj. {...};
6. Z. {...};
7. Znj. {...}.

Këtu përfunduar me zotin Alban Toro.

Kapim anëtarin tjetër relator.

*(Përzgjidhet anëtari i tretë i Komisionit.)*

Zonja Marçela Shehu.

Edhe për zonjën Shehu do ketë 7 kandidatë.

*(Përzgjidhen shtatë emrat e kandidatëve.)*

1. Znj. {...};
2. Znj. {...};
3. Z. {...};
4. Znj. {...};
5. Z. {...};
6. Znj. {...};
7. Z. {...}.

Emrat e tjerë ngelën për anëtarin, zotin Dritan Hallunaj.

1. Z. {...};
2. Z. {...};
3. Z. {...};
4. Z. {...};
5. Znj. {...}.

Këtu përfundoi procedura e shortit.

**Naureda Llagami:** Atëherë, Këshilli vendosi...

Po, zoti Toska!

**Ilir Toska:** Përpara se të kalojmë tek miratimi i vendimit përfundimtar, desha të sjell në vëmendje të Këshillit, se procedurat e verifikimit fillojnë menjëherë pas shortit, pra do duhet të njoftojmë të gjithë kandidatët dhe disa ditë më pas (jo më vonë se tre ditë), të nisin deklaratat që ata duhet të plotësojnë. Ndërkohë, sipas rregullores, miratuar me vendimin nr. 75, kandidatët, sa i përket deklaratës së pasurisë, duhet ta dorëzojnë atë pranë ILDKPKI-së, brenda 21 ditëve nga marrja në dorëzim e deklaratës. I bie që, e gjithë periudha duhet të jetë përgjatë muajit gusht, kohë kur institucionet praktikisht janë të mbyllur për shkak të lejeve vjetore që kryejnë. Mbase Këshilli mund të konsiderojë që të shtyjë afatin për këta kandidatë deri në fillim të shtatorit, për të mos pasur konsekuenca sa i përket dokumentacionit që duhet të dorëzojnë bashkë me deklaratën e pasurisë, pra që të jemi të gjithë në një procedurë shumë të hapur dhe transparente, por edhe të barabartë për të gjithë. T'i japim mundësi këtyre që të kenë mundësi të marrin dokumentat e nevojshme dhe t'i dorëzojnë ato. Pra Këshilli të konsiderojë që të lejë një afat vetëm për këto kandidatë, meqë qëlloi muaji gusht kur fillojnë procedurat, të jetë java e parë e shtatorit të vitit 2019.

Ky ishte një propozim. Nëse doni një formulim, mund të jetë: “Afati për dorëzimin nga kandidatët të deklaratës së pasurisë, të jetë deri në datë 6 shtator 2019 (është dita e fundit e javës së parë të muajit shtator). Data 5 është festë zyrtare “Shenjtërimi i Nënë Terezës”, ndërkohë që data 6 është edhe dita e fundit e javës, mundet të jetë një afat optimal. Nga ana tjetër, ju bëj të ditur që në njoftimet për shpalljet e vendeve të lira, të gjithë të interesuarit që do të konsideronin të aplikonin, i është bërë thirrje që të konsiderojnë marrjen e çdo dokumentacioni të nevojshëm që do i nevojitej në rastin e aplikimit dhe dorëzimit të deklaratës së pasurisë. Gjithsesi ky është propozim që mund ta konsideroni. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Atëherë, faleminderit zoti Toska!

**Ilir Toska:** Jemi dakord me propozimin e bërë nga zoti Toska lidhur me përcaktimin në vendim të një afati të dorëzimit për deklaratën e pasurisë deri më datë 6 shtator 2019? Jemi dakord me këtë propozim?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, për efekt të transparencës, unë do doja edhe një herë të përmendja relatorët përkatës për secilin nga kandidatët. Kështu, Këshilli vendosi: Së pari, fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve të përzgjedhjes së kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur, për në pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë; Caktimin e relatorit për secilin kandidat që ka dorëzuar kërkesën për t'u emëruar në Gjykatën e Lartë, si më poshtë:

1. Për z. {...}, relator zoti Dritan Hallunaj;
2. Për z. {...}, relator zonja Marçela Shehu;
3. Për z. {...}, relator zoti Ilir Toska;
4. Për z. {...}, relator zoti Alban Toro;
5. Për z. {...}, relator zoti Alban Toro;
6. Për z. {...}, relator zoti Ilir Toska;
7. Për z. {...}, relator zonja Marçela Shehu;
8. Për z. {...}, relator zoti Ilir Toska;
9. Për z. {...}, relator zoti Alban Toro;
10. Për z. {...}, relator zonja Marçela Shehu;
11. Për z. {...}, relator zoti Dritan Hallunaj;
12. Për z. {...}, relator zonja Marçela Shehu;
13. Për z. {...}, relator zoti Alban Toro;
14. Për z. Irena Nino, relator zonja Marçela Shehu;
15. Për z. {...}, relator zoti Alban Toro;
16. Për z. {...}, relator zonja Marçela Shehu;

17. Për z. {...}, relator zoti Dritan Hallunaj;
18. Për z. {...}, relator zoti Dritan Hallunaj;
19. Për z. {...}, relator zoti Alban Toro;
20. Për z. {...}, relator zonja Marçela Shehu;
21. Për z. {...}, relator zoti Dritan Hallunaj;
22. Për z. {...}, relator zoti Alban Toro;

Afati i dorëzimit të deklaratës së pasurisë do të jetë data 6 shtator. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 26.07.2019)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:07 dhe mbaroi në orën 14:57.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Illir Toska*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
9. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zonja Brunilda Kadi**.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.**
- 6. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.**
- 7. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**
- 8. Aurora Ndreu, Specialiste pranë Sektorit të Oponencës Juridike dhe Përafrimit të Legjislacionit.**
- 9. Edlira Bako, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 10. Sindi Liço, Qendra Evropiane.**
- 11. Erion Fejzulla, USAID.**
- 12. Julinda Beqiraj, EURALIUS.**

#### **RENDI I DITËS:**

2. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në çështjen e dytë të rendit të ditës e cila ka të bëjë me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Relatimi i këtij projekt-akti do bëhet nga kryetari i këtij Komisioni, zoti Ilir Toska.

**Ilir Toska:** Faleminderit!

Do duhet të relatojë për secilën gjykatë në nevojë që është Gjykata e Lartë dhe disa gjykata të tjera. Por duhet të kemi vendin atje.

*(Kameramanët largohen nga salla e mbledhjes, ashtu si edhe një pjesë e gazetarëve.)*

Atëherë, fillojmë me pikën e dytë të rendit të ditës. Fillimisht kemi propozim për radhën e procedurave të shortit sipas gjykatave. Kemi bërë këtë propozim. Fillimisht, procedurat e shortit për Gjykatën e Lartë. Pastaj procedura e shortit për disa gjykata të shkallës së parë që kanë paraqitur raste urgjente, që janë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet. Nga ana tjetër kemi edhe një propozim dhe relacionin e projektvendimit për ndryshimin e vendimit nr. 139 të datës 19 korrik 2019, sa i përket caktimit të një gjyqtari në një çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, për të cilën do duhet ta relatoj që do të duhet ta ndryshojë Këshilli këtë vendim.

Propozoj të fillojmë me procedurat e shortit, por duhet të bini dakord me radhën paraprakisht.

**Naureda Llagami:** Jemi dakord me radhën?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

**Ilir Toska:** Mirë atëherë. Relatimi i parë lidhet me nevojat e **Gjykatës së Lartë**. Sipas kërkesës së paraqitur nga Gjykata e Lartë deri më datë 25 korrik, paraqet nevojë në 4 çështje që lidhen me ekstradimet e të dënuarve. Në kërkesë është evidentuar nevojë për

1 gjyqtar, ndërsa është referuar pasja në gjykatë e dy gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë, zoti {...} dhe zoti {...}. Ndërkohë, ditën e sotme, në një seancë publike, është shpallur vendimi nga Kolegji i Posaçëm i Apelit në lidhje me zotin {...}, për të cilin është vendosur “Shkarkimi nga detyra”. Në këto kushte, jemi para situatës që Gjykata e Lartë është në nevojë për 4 çështje gjyqësore që kanë të bëjnë me ekstradimin, ndërsa numri i nevojshëm i gjyqtarëve që do duhet për gjykimin e tyre është 2, referuar faktit që 1 gjyqtar është në detyrë pranë Gjykatës së Lartë, zoti {...}. Kemi bërë propozim që gjyqtarët që duhet të caktohen për 4 çështjet gjyqësore si më lart, të jenë nga gjykata e apelit me juridiksion të përgjithshëm, nga Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda. Gjyqtarët duhet të kenë të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit si dhe të kenë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për 4 çështjet, të jetë 2. Krahas kësaj, keni edhe listën e gjyqtarëve nga mund të përzgjedhim 2 gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e këtyre çështjeve, janë: {...}...-...{...}.

Jeni dakord për këtë?

**Medi Bici:** Përfashtoje Margaritën se e kemi përfashtuar edhe nga... është në KED. Përfashtoje nga shorti!

E kam propozim. E kemi përfashtuar edhe nga shorte të tjera, nga ngarkesa e Gjykatës së Apelit Vlorë. Ato janë në kulmin e veprimtarisë.

**Naureda Llagami:** Jeni dakord për përfashtimin... Atëherë, jeni dakord me propozimin që bëri zoti Bici për përfashtimin e zonjës {...} tek shorti?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Alban Toro:** Kundër.

**Ilir Toska:** Kundër.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Kundër.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Kundër.



Jeni dakord për pjesën tjetër?

*Maksim Qoku*: Dakord.

*Dritan Hallunaj*: Pro.

*Alban Toro*: Dakord.

*Ilir Toska*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Pro.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Erjon Muharremaj*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Medi Bici*: Pro.

*Naureda Llagami*: Dakord.

*Ilir Toska*: Hedhim në enë emrat e gjyqtarëve që janë {...}...-...{...}. Do përzgjedhim emrat e dy prej tyre.

Emri i parë është {...}.

Emri i dytë është {...}.

Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Lartë.

Vazhdojmë procedurat e shortit për **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin**. Ka paraqitur kërkesë dhe është në nevojë për 1 çështje që ka urgjencë, është për “Sigurim prove për marrjen e dëshmisë”. Në këtë rast nuk zbatohen skena e delegimit për shkak të padisponueshmërisë të gjyqtarëve në skemën e delegimit dhe as transferimi i përkohshëm, ndërsa bëhet fjalë për 1 çështje dhe dobishmëria e saj nuk është efektive. Referuar vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” si dhe në zbatim të paragrafit VI, pika 4, të këtij vendimi, Komisioni propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 2. Në opsionin e pranimit të këtij propozimi, për ekonomizim të burimeve njerëzore vlen të konsiderohet shorti i zhvilluar, më datë 19.07.2019, në lidhje me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në

Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, ku nisur nga kjo, për hapat e shortit që duhet të ndiqen, Komisioni ka bërë këtë propozim: Për 1 çështje penale, për të cilën kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, duke u konsideruar shorti i datës 19.07.2019, si të përzgjedhur nga shorti të konsiderohen dy gjyqtarët e Seksionit Penal të çështjeve penale të themelit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, konkretisht {...} dhe {...}. Jeni dakord?

*Naureda Llagami:* Dakord?

Dakord të gjithë me propozimin.

*Ilir Toska:* Atëherë, meqenëse Këshilli është dakord, i konsiderojmë të përfunduara procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Vazhdojmë me një gjykatë tjetër.

Vazhdojmë procedurat e shortit për nevojat e **Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje**. Ka paraqitur nevojë urgjente për 1 çështje penale me të arrestuar. Kërkohet caktimi i 1 gjyqtari. Edhe në këtë rast nuk mund të zbatohet mekanizmi i skemës së delegimit për shkak të padisponueshmërisë së gjyqtarëve, ndërsa është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë kështu i aplikueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit Komisioni propozon që gjykata nga duhet të zgjidhet me short gjyqtari që caktohet për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1. Në opsionin e pranimit të propozimit si më lart, për hapat e shortit që duhet të ndiqen, Komisioni propozon që për një çështje penale për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dhe të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë, zëvendëskryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, zoti Durim Hasa. Jeni dakord?

*(Anëtarët janë dakord.)*

*Brikena Ukperaj:* Kam edhe një propozim zoti kryetar.

Duke marrë parasysh që zonja Rudina Palloj ka aplikuar në Këshillin e Lartë Gjyqësor për një nga pozicionet e shpallura si gjyqtare e komanduar në Njësinë e

Vlerësimit dhe në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve, do të propozoja që duke mos ditur ecurinë e çështjes, të përjashtohet ajo nga shorti, marrë parasysh që brenda muajit shtator Këshillit të Lartë Gjyqësor, pa paragjykuar vendimin, duhet të përfundojë procedurat për komandimin e gjyqtarit.

*Maksim Qoku:* Dakord.

*Dritan Hallunaj:* Pro.

*Alban Toro:* Kundër.

*Ilir Toska:* Dakord.

*Fatmira Luli:* Pro.

*Marçela Shehu:* Kundër.

*Erjon Muharremaj:* Pro.

*Brikena Ukperaj:* Pro.

*Medi Bici:* Pro.

*Naureda Llagami:* Pro.

*Ilir Toska:* Fusim në një enë emrat e tjerë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, janë: {...}...-...{...}. Do përzgjedhim emrin e njërit prej tyre.

Emri i përzgjedhur është {...}.

Me kaq mbyllet procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.

Vazhdojmë me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje. Mbaruam Lushnjën. Vazhdojmë me Beratin.

Atëherë, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat** ka nevojë për 1 çështje gjyqësore. Kërkohet caktimi i 1 gjyqtari (është lëndë penale). Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit për shkak të padisponueshmërisë së gjyqtarëve në skemë, ndërsa është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarëve, duke qenë kështu i aplikueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit Komisioni propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, ndërsa numri i gjyqtarëve që duhet të caktohet, të jetë 1.

Në opion të pranimit të këtij propozimi kemi propozuar që të përjashtohet vetëm kryetarja në detyrë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, zonja {...}.

*(Anëtarët janë dakord.)*

Atëherë, meqenëse jeni dakord, fillojmë procedurat e shortit. Fusim në një enë emrat e gjyqtarëve të Seksionit Penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, që janë: {...}-...-...{...}. Do përzgjedhim emrin e njërit prej tyre - {...}. Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet**. Edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet ka paraqitur një kërkesë urgjente për 1 çështje në lëndë penale, me objekt “Rivlerësim mase mjekësore”, nëpërmjet të cilës kërkohet caktimi i 1 gjyqtari. Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit për shkak padisponueshmërie të gjyqtarëve në këtë skemë, ndërsa është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, duke qenë kështu i aplikueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, ku referuar të cilit Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, ndërsa numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje, të jetë 1. Në opion të pranimit të këtij propozimi, përjashtimet nga shorti, Komisioni propozon të përjashtohet vetëm kryetari në detyrë, zëvendëskryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, zoti {...}. Jeni dakord me këtë propozim?

*(Anëtarët janë dakord.)*

Mirë, meqenëse jeni dakord me propozimin e bërë nga Komisioni, vazhdojmë me procedurat e shortit. Hedhim në një enë emrat e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, që janë: {...}, {...}, {...}. Këto tre emra janë. Do të përzgjedhim emrin e njërit prej tyre – {...} është emri që përzgjidhet. Me kaq mbyllet procedura e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet.

Atëherë, kemi bërë edhe një propozim për ndryshimin e pjesëshëm të vendimit 139, datë 19.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për caktimin e gjyqtarit në një çështje gjyqësore të veçantë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat”. Do duhet të relatoj se me kërkesat e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, për caktim gjyqtari për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, të ardhura deri më datë 19.07.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka shqyrtuar, ndër të tjera, edhe kërkesën, protokolluar nr. 3886 prot., datë 18.07.2019, që identifikonte si nevojë të kësaj gjykate, është çështja nr. 2 e renditur në atë listë, është në lëndë penale, objekti i kërkesës ka qenë “Dërgimin e çështjes në gjyq”, ndërsa numri i gjyqtarëve që kërkoheshin për t’u caktuar ka qenë 1.

Për kërkesat e ardhura deri me datë 19.07.2019 nga kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm, Këshilli i Lartë Gjyqësor zbatoi vendimin “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin”, ku bazuar në të cilin i ka propozuar Këshillit që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e dy çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, ndërsa numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e dy çështjeve gjyqësore të veçanta, të ishte 1. Propozimi i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës është pranuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor ku mbi këtë bazë është zhvilluar procedura e shortit, për përzgjedhjen e 1 gjyqtari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, për 2 çështjet gjyqësore të veçanta, që kërkohet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat.

Në këtë rast, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka pranuar edhe propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës për përjashtimin nga shorti të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, i cili do të caktohet për gjykimin e çështjeve Gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Përmes shortit në atë rast është përzgjedhur gjyqtarja {...}.

Mbi këtë bazë, me vendimin nr.139, datë 19.07.2019, paragrafi I, nënndarja “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat”, pika 2, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ndër të tjera, ka vendosur se Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, {...}, caktohet në përbërje të

trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, çështjen penale me të pandehur: {...}; me objekt: Kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq”.

Mbas njoftimit të këtij vendimi, Kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, z.{...}, përmes e-mailit të datës 26.07.2019, ka bere me dije se sa i përkiste caktimit të gjyqtarës {...}, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, në gjykimin e çështjes penale si më lart, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk ishte mbajtur parasysh se gjyqtarja në fjalë kishte pengese ligjore, ndërsa ajo ka qenë gjyqtarja e seancës paraprake dhe kishte vendosur dërgimin e çështjes penale për gjykim.

Nga shqyrtimi i materialeve, pikërisht i Shkresës së Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr.3886 prot., datë 18.07.2019, rezulton të jetë bërë prezent fakti se për çështjen penale si më lart kërkohej caktimi i 1 gjyqtari, ndërsa kishin pengese për gjykimin e saj, ndër të tjerë edhe gjyqtarja {...}, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë. Ndërkohë, një fakt i tille është evidentuar edhe në relacionin e përgatitur në atë rast nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Por pavarësisht kësaj, një rrethanë e tille, pra pasja pengese ligjore për gjykimin e çështjes penale si më lart nga gjyqtarja {...} rezulton të mos jetë mbajtur parasysh nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në procedurat e shortit, ku bazuar në rezultatin e të cilit është marrë vendimi nr. 139, datë 19.07.2019, paragrafi I, nënndarja “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat”, pika 2, përmes të cilit gjyqtarja {...} është caktuar përsëri për gjykimin e të njëjtës çështje penale.

Në këto kushte, bazuar në nenet 113 dhe 117 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në nenin 99 të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, është vendi për ndryshimin e pikës 2, të nënndarjes “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat”, të paragrafit I, të vendimit nr. 139, datë 19.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sa i përket gjyqtarit të caktuar për gjykimin e çështjes penale si më lart.

Lidhur me gjyqtarin që duhet të caktohet për gjykimin e asaj çështje gjyqësore të veçantë, duke konsideruar propozimet e pranuar në mbledhjen e datës 19.07.2019, sa i përket gjykatës nga duhet të caktohet gjyqtari, pra Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, si dhe sa i përket gjyqtarit të kësaj gjykate që përjashtohen nga shorti, pra gjyqtarit që do të

caktohej për gjykimin e çështjeve të veçanta në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku mbas shortit të hedhur në atë rast është përzgjedhur gjyqtarja {...}, patur parasysh gjyqtarët në detyrë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, mbetet që për gjykimin e çështjes penale si më lart, gjyqtari që duhet të caktohet, praktikisht i përzgjedhur nga shorti është pikërisht gjyqtarja {...}, pasi kjo gjykatë ka tre gjyqtarë në detyrë (pra Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë), nga të cilët një gjyqtar, znj. {...}, është caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndërsa një gjyqtar tjetër, znj. {...}, ka pengesë ligjore për gjykimin e çështjes në fjalë.

Vlen të konsiderohet në këtë rast edhe saktësimi i objekti i çështjes si më lart, referuar informacionit të dërguar me e-mailin e datës 19.07.2019, nga Kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, konkretisht çështja nuk është për “dërgim në gjyq” por është gjykimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit {...}, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta”, parashikuar nga neni 279/2 i Kodit Penal.

Sa me sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon: Ndryshimin e pikës 2, nënndarja “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat”, paragrafi I, të vendimit nr.139, datë 19.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në këtë mënyrë: “2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit {...}, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta”, parashikuar nga neni 279/2 i Kodit Penal”. Ky është edhe propozimi jonë.

**Naureda Llagami:** Jemi dakord me propozimin?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Alban Toro:** Dakord.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Pro.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Medi Bici*: Pro.

*Naureda Llagami*: Pro.

Atëherë, nëse nuk keni ndonjë gjë tjetër, unë e deklaroj këtë mbledhje të mbyllur.  
Faleminderit për prezencën. Mirupafshim!

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**